

MODEL TESTI- PROVIM ME ZGJEDHJE

NJOHURI PËR SHOQËRINË-EKONOMI E ZBATUAR-HYRJE NË FILOZOFI

Modeli që është paraqitur është vetëm orientues për kandidatët.

Orientime të përgjithshme

1. Hartimi i testit mbështetet në programin orientues të miratuar nga MASH si dhe tekstet përkatëse.
2. Testi do të përmbaj 50 kërkesa në total, ku 22 kërkesa do të jenë nga lënda Njohuri për shoqërinë, 11 kërkesa nga lënda Hyrje në filozofi dhe 17 kërkesa nga lënda Ekonomi e zbatuar. Numri i kërkesave është në raport me peshën që zenë këto lëndë në shkollën e mesme.
3. Niveli i vështirësisë së testit është në përputhje me qëllimin për të cilin ai përdoret. Provimet me zgjedhje janë provime hyrëse në shkollën e lartë dhe pjesë e provimeve të Maturës Shtetërore.
4. Testi do të përmbaj kërkesa të niveleve të ndryshme të vështirësisë. 35% e kërkesave do të jenë të nivelit të parë, (njohje e informacionit dhe të kuptuarit) 40% të kërkesave do të jenë të nivelit të dytë (analizë/sintezë, interpretim të dhënash, faktesh) dhe 25 % të kërkesave do të jenë të nivelit të tretë të vështirësisë (zbatim i informacionit në situata të reja)
5. Tipi i kërkesave do të jetë objektiv, të formatit me zgjedhje të shumta. (alternativa). Cdo kërkesë do të përmbaj 4 (katër) alternativa, ku vetëm njera është e saktë.
6. Përgjigjen e saktë, kandidati do ta jap në fletën e përgjigjeve, e cila është një fletë e vecantë nga testi.
7. Koha për zhvillimin e një kërkesë të testit është afërsisht 1 (një)minut.Koha totale për zhvillimin e të gjitha kërkesave të testit (50 kërkesa) është 50 minuta.
8. Vlerësimi i përgjigjes së saktë është 1(një) pikë. Për cdo përgjigje të gabuar, kandidati vlerësohet me 0 (zero) pikë.

Shtrirja e kërkesave sipas programit

Numri i kërkesave për cdo temë brenda cdo lënde është në varësi të peshës që zë ajo (tema) Psh, në lëndën “Njohuri për shoqërinë” kapitulli i kulturës zë peshën më të madhe, dhe nga ky kapitull do të ketë rreth 5 kërkesa në test.Ndërsa temat e tjera do të kenë 2 ose 1 kërkesë sipas peshës që ato zenë në program. Po kështu dhe në lëndën Hyrje në filozofi dhe Ekonomi e zbatuar.

Pra, në test do të ketë kërkesa nga i gjithë programi orientues sipas peshave që temat zënë.

Më poshtë po japim shembuj kërkesash nga të treja lëndët.

Seksioni : Njohuri për shoqërinë

1. Në jug të vendit tonë jeton një komunitet me fe dalluese nga ajo e shumicës së shqiptarëve dhe me një mënyrë jetese etnike. Ky grup mund të karakterizohet si

- A. kundërkulturë.
- B. kulturë jomateriale.
- C. kulturë etnocentrike.
- D. nënkulturë.

2. Një ditë kur nxënësit panë shokun e tyre të veshur sipas modës së vjetër filluan të qeshin dhe të bëjnë shaka me njëri tjetrin. Në këtë rast, shoku kishte shkelur një

- A. folkuej.
- B. ligj.
- C. more.
- D. vlerë kulturore.

3. Agimi u martua me Elën, por gjithashtu vendos të martohet edhe me Besën. Cili nga termat e mëposhtëm përshkruan më mirë këtë tip martesë ?

- A. Monogami.
- B. Poliandri.
- C. Poligjini.
- D. Orgji.

4. Prijet fundamentaliste janë të pranishme në besimin

- A. islamik.
- B. katolik.
- C. ortodoks.
- D. në të gjitha besimet fetare

5. Akoma edhe sot në disa vende djemve u ndalohet mbajtja e flokëve të gjatë. Cilin karakter të shmangies dëshmon ky shembull ?

- A. Absolut.
- B. Përgjithësues.
- C. Relativ.
- D. Të përhershëm.

Seksioni : Hyrje në filozofi

1. Në kuptimin e saj fillestar fjala filozofi do të thotë

- A. të jesh i/e ditur.
- B. të kërkosh diturinë.
- C. të duash diturinë.
- D. të shtosh diturinë.

3. Cila nga kategoritë e mëposhteme është më e rëndësishme për teologjinë ?

- A. Arësyeja njerëzore.
- B. Besimi tek zoti.
- C. Dija njerëzore.
- D. Frika ndaj zotit.

3. Cila nga deklaratat e mëposhteme e pasqyron më mirë frymën e Rilindjes Europiane ?

- A. Besimi tek Zoti është e vetmja mënyrë për ta ciluar njeriun nga mjerimi tokësor.
- B. Njeriu është në qendër të universit si vendtakimi i të fundmes dhe pafundësisë, të vërtetës dhe të përjetëshmes.
- C. Njeriu duhet që me përvuajtje t'i nënshtrohet Zotit.
- D. Njeriu është vetëm njëri nga aspektet e shumta në planin universal të Zotit.

Seksioni : Ekonomi e zbatuar

1. Një politikë e mirëfilltë fiskale së bashku me një politikë monetare konservatore do të ndikojë në

- A. një rritje të prodhimit kombëtar.
- B. një ulje të deficitit të buxhetit.
- C. rritje të normave të interesit.
- D. zvoglim të prodhimit kombëtar.

2. Nëqoftëse cmimi i celikut që përdoret për prodhimin e automobilave pëson një rritje, oferta e automobilave do të

- A. rritet, ndërsa kërkesa do të zvoglohet.
- B. rritet sëbashku me kërkesën.
- C. zvogëlohet , ndërsa kërkesa do të rritet.
- D. zvogëlohet së bashku me kërkesën.

3. Cila nga të mëposhtmet ka një kontribut minimal për formimin e një monopoli tek një sipërmarrje ?

- A. Kufizimet ligjore.
- B. Prania e pengesave kundrejt hyrjes në treg.
- C. Teknologjitë e patentuara.
- D. Vendosja e taksave për mallrat e importit.